
**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin aktual akademik 2024/2025 i krahasuar me vitet paraprake
2023/2024 , 2022/2023 dhe 2021/22,
Programi: **Informatikë e Aplikuar****

1. Hyrja

Në kuadër të këtij fakulteti, **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës** ofrohet programi i studimeve ***Inxhinieri Industriale me Informatikë***, në ciklin e parë, pra në bachelor, programi i studimeve në ***Informatikë të Aplikuar***, në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe programi i studimeve në ***Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit*** në ciklin e dytë, pra në master.

Programi: *Informatikë të Aplikuar* ne kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Informatikës gjatë vitit akademik 2024/25 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar në vitin 2023 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është të zhvillojë kuadro të specializuara të profesionistëve në fushën e Inxhinierisë dhe TI, me fokus në atë zhvillimin dhe dizajnin e produkteve duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të TI-së , të cilat i përshtaten lehtë kërkesave të tregut të punës. Ky mision është në harmoni me misionin e institucionit “...*të përgatisim profesionistë të kualifikuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.*”

Ne kemi qëllim që të krijojmë profesionist në fushën e *Informatikës së Aplikuar*, duke ndihmuar në strukturimin dhe organizimin e kompanive industriale për të përmirësuar zhvillimin e kompanisë si dhe gjenerimin e ideve që avancojnë praktikën e Inxhinierisë.


Raporti përmban të dhëna për vlerësimin e programit nga studentet dhe për vlerësimin e mësimdhënësve nga studentet në programin *Informatikë e Aplikuar* për vitin aktual 2024/25 i cili krahasohet me vitet paraprake 2023/24, 2022/23, 2021/22.

2. Raporti i përmblodhur i vlerësimit të cilësisë (program, mësimdhënës)

Raporti i përmblodhur - për dy fushat (program dhe mësimdhënës) paraqet ne Tabelën nr. 1 - statistikat për vitin akademik 2023/24, i ilustruar edhe ne Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Vitët Paraprake					Viti aktual
	2019/20	2020/21	2021/22	2022/23	2023/24	2024/25
Vlerësimi mësimdhënës/nxënës (programi)	///	///	3.82	3.91	3.86	4.08
Vlerësimi i stafit akademik	///	///	4.1	4.2	4.29	4.3



Nga raporti përmblodhur i paraqitur në tabelën nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim një vlerësim për vitin akademik 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024 dhe 2024/2025.

Duke i u referuar tabelës, vlerësimi i cilësisë për vitin akademik 2024/2025 është me notën 4.08 që konsiderohet si vlerësim shumë i mirë. Në kuadër të fushës të vlerësimit të stafit akademik është një vlerësim me notën 4.3, vlerësim shumë i mirë, presim një ngritje në vlerësimin e stafit në vitet e ardhshme nga ana e studentëve.

Në të dy rastet kemi vlerësim si në Vlerësimin mësimdhënës/nxënës (programi) nga 4.08 dhe në Vlerësimin e stafit akademik nga 4.3 në vitin 2024/2025 krahasuar me vitet paraprake është një trend pozitiv.

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit *Informatikë të Aplikuar* 2024/25 është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 21 komponentë, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Bazuar në rezultate e vlerësimit të programi - mësimdhënia dhe mësim-nxënia të paraqitura në tabelën nr.2, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare e vlerësimit të programit për të tri vitet akademike është rreth 3.8 që është një vlerësim shumë i mirë.

Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – Informatikë të Aplikuar

	Vitet paraprake				Viti aktual
	2020/21	2021/22	2022/23	2023/2024	2024/2025
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht		4.04	4.14	3.74	3.95
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit		4.08	4.00	4.00	4.15
Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve		3.84	4.22	4.05	4.35
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve		3.92	3.90	3.73	4
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet		3.68	3.76	3.76	3.91
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse		4.04	4.25	3.98	4.13
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies		3.68	3.95	3.82	3.97
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë		3.48	3.42	4.65	4.8
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve		3.60	4.31	3.91	4.06
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë		3.80	3.75	3.64	3.79
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik		3.88	3.93	3.83	3.98
Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore		3.64	3.68	3.85	4.15
Orari i mësimi shpallet me kohë		3.96	3.80	3.80	3.95
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit		3.84	3.93	3.74	4.2
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës		3.64	3.95	3.94	4.09

Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera		3.80	3.80	3.83	3.98
Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)		3.88	3.83	3.71	3.96
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti		3.72	3.66	3.50	3.96
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët		3.68	3.76	3.79	3.94
Mendimi im i përgjithshëm për këtë		3.96	4.02	3.94	4.2
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve		-	4.02	3.95	4.1
Mesatarja e vlerësimit të programit		3.8	3.91	3.86	4.08

Nga analiza për vlerësimin e programit nga studentet vijmë në përfundimin se për vitin akademik për të cilin janë prezantuar në tabelën nr.2 rezultatet ka një vlerësim i mirë, disa nga 21 komponentët e vlerësimit janë të vlerësuar me note mesatare mbi 3.96 që është një vlerësim i shkëlqyeshëm dhe ka disa komponentë që janë vlerësuar me note mesatare nën 3.96 që konsiderojmë se ka hapësirë për të rritur angazhimin me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm, duke u bazuar në përfundimet e nxjerra dalin rekomandime.

Komponentët që kërkojnë një angazhim më të madhë për përmirësim të cilësisë janë: Mësimi “on-line” përmes platformës Microsoft Teams e cila është përdorur gjatë kohës së profesorëve të angazhuar. Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti, Orari i konsultimeve me mësimdhënësit duhet të respektohet, mënyra e vlerësimit të studenteve, Raporti në mes pjesës teorike dhe praktike – për këto komponentë duhet angazhim i menaxhmenti dhe organizim më i mirë i stafit për ngritje të cilësisë dhe të rezultateve.

4. Raporti i vlerësimit të mësimdhënësit

Raporti i vlerësimit për mësimdhënësin paraqet statistikën për vitin akademik 2022/2023. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i mësimdhënësit/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 23 komponentë për të cilat është gjetur nota mesatare.

Mësimdhënësit dhe lëndët të cilat janë pjesë të programit **Informatikë të Aplikuar** janë vlerësuar me note mesatare të shkëlqyeshme (nota kryesisht mbi 4) kjo tregon se studentet e kanë vlerësuar kënaqshmërisë e programit me 86% që është një arritur e jashtëzakonshme për këtë program. Duke analizuar detajet e raportit vijmë në përfundimin se ka disa mësimdhënësit dhe lëndët të cilat kanë marrë një vlerësim më të lartë (mbi notën 4) dhe ka disa mësimdhënësit dhe lëndët që kanë marrë një vlerësim më të ulët (nën notën 4), në bazë të këtyre të gjeturave rekomandojmë që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga mësimdhënësit në të gjitha lëndët të cilat kanë një vlerësim me notën 3 deri në 3.99 duke bërë përpjekje që këto vlerësime të përmirësohen në vitet pasuese.